



Bazuar në Nenet 95 dhe 96 të Ligjit Nr. 08/L – 197 për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, në mbështetje të Rregullores (QRK) Nr. 27/2024 për Procedurat e Konkurrimit për Nëpunësit Teknik dhe Mbështetës, Agjencia Kosovare e Privatizimit shpall konkurs:

PASTRUES
(1 Pozitë)

Numri i Referencës: 01 / 2026

Lloji i Pozitës: Pozitë e Lirë

Orari: I plotë

Klasa: I 22

Koeficienti: 4.78

Departamenti: Departamenti i Administratës

Vendi i Punës: Divizioni i Zyrës Rajonale Prizren

QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I POZITËS

Mirëmbajtja e higjienës dhe mirëmbajtja e zyrave në Zyrat rajonale të AKP-së;

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Pastrimi i zyrave, korridoreve, sallave për konferenca, magazinave, arkivave dhe tualeteve që përfshin: pastrimin e dyshemeve me makinë thithëse, lustrimin e dyshemesë, larjen dhe dezinfektimin e tualeteve si dhe pastrim gjeneral të objektit një herë në muaj;
- Pastrimi i pluhurit nga të gjitha sipërfaqet e pajisjeve nëpër zyre, korridore dhe hapësirave tjera;
- Zbrazja e rregullt e shportave të plehut nëpër zyre, korridore dhe tualete;
- Pastrimi i tualetit që përfshin: larjen dhe dezinfektimin e guacave, lavamanëve dhe dyshemesë;
- Rimbushja e rregullt e aparateve me letra të tualetit si dhe ato të duarve;
- Rimbushja e aparateve për pastrimin e duarve;
- Mirëmbajtja dhe pastrimi i të gjitha pajisjeve të shfrytëzuara të pastrimit;
- Kryerja e detyrave tjera sipas udhëzimit të mbikëqyrësit.

PËRGATITJET PROFESIONALE / KUALIFIKIMET

- Diplomë e Shkollës së Mesme;
- Përvojë pune paraprake relevante minimum 1 vit;
- Shkathtësitë personale: gjendje të mirë fizike, i /e motivuar, një planifikues i /e avancuar dhe i mirë nën presion;
- Të jetë një entuziast dhe i /e aftë për të punuar;



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor;

Data e njoftimit në web faqen unike të procedurave të konkurrimit <https://konkursi.rks-gov.net> është nga data 29.01.2026.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 15 ditë, nga data **30.01.2026 deri me 13.02.2026 ora 16:00.**

Përshkrimi i detajuar i vendit të punës së bashku me aplikacionin për punë, përveç web faqes unike të procedurave të konkurrimit <https://konkursi.rks-gov.net>, publikohet edhe në web-faqe të Agjencisë:

www.pak-ks.org

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

Aplikacionin e plotësuar dhe të firmosur;
Letrën përcjellëse;
Dëshmi të kualifikimeve shkollore;
Dëshmi mbi përvojën e punës;
Certifikatën që nuk jeni nën hetime;
Dokumentin e identifikimit.

Mënyra e aplikimit:

Dokumentet e kërkuara si dhe Aplikacionet parashtrohen në adresën dhe në afatin e përcaktuar, përmes postës apo në mënyrë elektronike – SIMBNJ përmes webfaqes unike të procedurave të konkurrimit <https://konkursi.rks-gov.net> apo përmes e-mail adresës HR@pak-ks.org

Titulli i e-mailit tuaj duhet të përmbajë pozitën për të cilën ju aplikoni.

“ Agjencia Kosovare e Privatizimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komuniteti jo- shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e administratës publike qendrore dhe lokale.

Dokumentet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacioni dhe dokumentacioni i pakompletuar do të refuzohet.

Ne i falënderojmë të gjithë kandidatët për aplikim, por vetëm kandidatët në listën e ngushtë do të kontaktohen.